


STUDIM I SHKATHTËSIVE TË NEVOJSHME NË SEKTORIN E PËRPUNIMIT TË DRURIT NË KOSOVË

ME FOKUS TË VEÇANTË PËR PUNËTORËT PËR
VENDOSJEN DHE OPERIMIN E MJETEVE TË MAKINAVE PËR
PUNIMIN E DRURIT



**STUDIM I SHKATHËSIVE TË
NEVOJSHME NË SEKTORIN E
PËRPUNIMIT TË DRURIT NË KOSOVË:
ME FOKUS TË VEÇANTË PËR
PUNËTORËT PËR VENDOSJEN DHE
OPERIMIN E MJETEVE TË MAKINAVE
PËR PUNIMIN E DRURIT**

Shtator 2017

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	4
1. Hyrje dhe metodologjia	5
2. Pasqyra e sektorit.....	8
2.1 Madhësia e sektorit	8
2.2 Punësimi.....	10
2.3 Kërkesa e fuqisë punëtore	11
2.3.1 Kërkesa aktuale e fuqisë punëtore: Vendet e lira të regjistruara	11
2.3.2 Perspektiva e së ardhmes për kërkesat e fuqisë punëtore.....	12
2.3.3 Niveli i arsimimit: niveli i zakonshëm dhe i preferuar i arsimimit	13
2.3.4 Vështirësitë në rekrutimin e punëtorëve të aftë	14
2.4 Oferta e fuqisë punëtore dhe zhvillimi i aftësive.....	15
2.4.1 Oferta e fuqisë punëtore nga shkollat e mesme profesionale	15
2.4.2 Oferta e fuqisë punëtore nga qendrat e aftësimin profesional	16
2.4.3 Oferta e fuqisë punëtore nga arsimit i lartë.....	16
2.4.4 Zhvillimi i aftësive në ndërmarrje	16
2.4.5 Bashkëpunimi ndërmjet punëdhënësve dhe ofruesve të arsimit dhe trajnimit.....	17
3. Nevoja e aftësive për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit	19
3.1 Pasqyrë e profesionit	19
3.2 Detyrat dhe aftësitë specifike profesionale	19
3.2 Aftësitë e përgjithshme.....	22
3.3 Inovacionet, shtytësit e ndryshimit dhe adresimi i nevojave të paraqitura për aftësi.....	24
3.4 Kushtet e punës dhe gatishmëria fizike	24
4. Konkluzione dhe rekomandime	25
Burimet	28
Shtojcë: Çelësi i profesioneve ISCO-08	29



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Ky studim është përgatitur me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti për Arsim dhe Punësim në Kosovë – KEEN ” menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Lista e shkurtesave

KKN	Kontrolli Kompjuterik Numerik
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional

1. Hyrje dhe metodologjia

Përpunimi i drurit është ndër industritë prodhuese më të suksesshme për sa i përket zëvendësimit të importit, dhe është sektor i cili ka pasur rritje të vazhdueshme në vitet e fundit. Si i tillë, ai konsiderohet si një prej sektorëve me potencial të lartë për rritje, gjenerim të punësimit dhe eksport në Kosovë (p.sh. MTI, 2014; MTI dhe UNDP, 2014, 2015; USAID, 2015a). Sidoqoftë mungesa e aftësive raportohet nga ndërmarrjet që veprojnë në këtë sektor dhe ekziston një konsensus që niveli i aftësive të fuqisë punëtore është një prej pengesave kyçe të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit, dhe kjo po bëhet më e rëndësishme pasi që nevoja për të përshtatur teknologji të reja dhe për të përmbushur nevojat për tregun vendor dhe për eksport për produkte të cilësisë më të lartë është duke u rritur (MTI dhe UNDP, 2014; USAID, 2015a, b; EYE, 2016).

Niveli i aftësive të fuqisë punëtore është identifikuar si barrierë për sektorin privat; rrjedhimisht cilësia e arsimit dhe lidhjet e arsimit me nevojat e tregut të punës, me fokus të veçantë në arsimin profesional njihen si fushat kyçe të intervenimit në dokumentet strategjike kryesore të Qeverisë së Kosovës. Rrjedhimisht, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (2017-2021) njeh lidhjen e arsimit profesional me tregun e punës dhe mekanizmat të pazhvilluar sa duhet të sigurojnë të cilësisë si sfida kryesore (MASHT, 2016). Ngjashëm, Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021) sheh përputhjen e aftësive të fuqisë punëtore me nevojat e tregut të punës si parakusht për rritjen e investimeve, punësimit dhe të hyrave si dhe për rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese, e kjo pastaj do të përkthehet në rritje më të lartë ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm (ZKM, 2016).

Në këtë sfond, vlerësimet e aftësive për sektorin e përpunimit të drurit janë kryer më parë nga UNDP-ja (2016) dhe nga projekti EYE (2016). UNDP (2016) ka ofruar një analizë të nevojës për aftësi për “Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm” (Kodi 7522 në Standardet Ndërkombëtare për Klasifikimin e Profesioneve ISCO-08) në bazë të një hulumtimi të ndërmarrjeve. Ky profesion është zgjedhur në bazën e të qenit si një nga profesionet më të përhapura në sektor siç pohohet nga ndërmarrjet. Analiza nga EYE (2016), nga ana tjetër, nuk ishte përqendruar në një profesion të veçantë, por përkundrazi ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të kërkesës/mungesës së aftësive në sektor bazuar në të dhëna kualitative, si dhe në ofrimin e aftësive.

Ky studim i kontribuon literaturës ekzistuese mbi nevojat e aftësive për sektorin e përpunimit të drurit në dy mënyra. Së pari, bazuar në të dhënat dytësore dhe në një studim të disa prej firmave më të mëdha në këtë sektor, ai ofron hollësi për trendet në nivel sektori lidhur me rritjen e ndërmarrjeve dhe punësimin në profesione të ndryshme. Së dyti, ai ofron një analizë për profesione specifike për një profesion që konsiderohet vendimtar për realizimin e potencialit të sektorit. Rezultatet e studimit mund të përdoren nga ofruesit e arsimit dhe aftësimit dhe vendimmarrësit për zhvillimin e aftësive për punësim për përputhjen me kërkesat ekzistuese të tregut. Më tej, gjetjet mund të përdoren drejtpërdrejt për zhvillimin e standardeve profesionale për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, duke mbështetur kështu plotësimin e kornizës profesionale të AAP-së.

Metodologjia e zbatuar në këtë studim është marrë nga literatura/metodologjitë e kaluara për nevojat e aftësive në Kosovë (ALLED, 2016a, b, UNDP, 2016), si dhe studime në vendet e tjera ngjashëm me këtë, duke kombinuar një qasje të nivelit të sektorit dhe profesionit (p.sh. shih profilin e sektorit të drurit në Lituanë nga MCVET, 2008). Në pajtim me metodologjinë e zhvilluar nga ALLED (2016a, b) **studimi analizon kërkesën dhe ofertën e aftësive të sektorit** në sektorin e drurit duke grumbulluar informacione lidhur me punësimin dhe vendet e lira (kërkesa për punë) dhe të diplomuarit që vijnë nga arsimit (oferta e fuqisë punëtore). Analiza rrjedh nga: (i) studimet e mëparshme; (ii) të dhënat dytësore nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës (APRK) dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT); (iii) të

dhënat primare të mbledhura nëpërmjet një hulumtimi të 65 ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e drurit; (iv) intervistat me përfaqësuesit e ndërmarrjeve dhe aktorë të tjerë kryesorë.

Pika e nisjes për **zgjedhjen e profesionit** ishin gjetjet e kërkimeve të mëhershme në këtë fushë: Që të dyja UNDP (2016) dhe EYE (2016), gjejnë se punonjësit e aftësuar për të operuar me makineri dhe veçanërisht me makina me Kontroll Kompjuterik Numerik (CNC) janë një kërkesë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit, dhe kjo e fundit më tej thekson mungesën e kuadrove të kualifikuara për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave CNC si problem me të cilin përballet sektori. Pasi jemi siguruar se nuk ka standarde të profesionit miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në kohën kur është kryer kjo analizë¹, janë konsultuar aktorët kryesorë, duke përfshirë kreun e APRK-së, përfaqësuesit e MASHT-it dhe akademikë. Përveç konsensusit në mes të akterëve mbi rëndësinë e këtij profesioni për zhvillimin e sektorit të përpunimit të drurit, përzgjedhja e këtij profesioni plotëson edhe një kusht tjetër për sa i përket shtrirjes dhe rëndësisë: Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit pritet të nevojiten/gjenden nëpër nën-sektorë dhe ndërmarrje të ndryshme (pavarësisht madhësisë së ndërmarrjes).

Analiza për profesionin e zgjedhur “Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit” (ISCO 08 Kodi 7523) është e bazuar në metodologjinë e zhvilluar dhe pilotuar më parë nga UNDP (2016) me kontributin nga ALLED. Ajo kryesisht rrjedh nga hulumtimi i ndërmarrjeve, me gjetjet e miratuara dhe të plotësuara me intervista të thukëta me dy ndërmarrje (një të vogël dhe një të mesme).

Mostra për anketën e ndërmarrjes është nxjerrë nga regjistri i ndërmarrjeve në ATK (2016). Studimi është shtrirë tek të gjitha aktivitetet e prodhimit të përpunimit të drurit, siç janë regjistruar në bazën e të dhënave në ATK (shih Tabelën 1.1).

Tabela 1.1: Aktivitetet ekonomike të mbuluara në studim

Kodi NACE	Aktiviteti ekonomik
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës, përveç mobileve; prodhimi i artikujve të kashtës dhe materialeve të thurjes
16.10	Sharrimi dhe planifikimi i drurit
16.21	Prodhimi i shtresave lustruese dhe paneleve me bazë druri
16.23	Prodhimi i mjeteve të tjera të zdrukthëtarisë dhe lidhjes për ndërtim
16.24	Prodhimi i kontejnerëve/enëve nga druri
16.29	Prodhimi i drurit dhe produkteve tjera të drurit, prodhimi i artikujve të tapës, kashtës dhe materialeve të thurjes
31	Prodhimi i mobileve
31.01	Prodhimi i mobileve për zyrë dhe dyqan
31.02	Prodhimi i mobileve të kuzhinës
31.09	Prodhimi i mobileve tjera

Duke pasur parasysh fokusin e studimit, ndërmarrjet e mëdha janë përzgjedhur në mostër nën supozimin se përfaqësuesit e tyre janë më të informuar për aftësitë e fuqisë punëtore, aftësitë e

¹ Një standard i përafërt profesioni për sektorin e përpunimit të drurit, “Dizajn interieri dhe teknologji e drurit” është zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, megjithatë deri më tani nuk është miratuar nga AKK-ja.

nevojshme për profesion (duke përfshirë ato që lidhen me teknologjinë më të avancuar), dhe trendet në kuptim të nevojave për aftësi në të ardhmen dhe perspektivat e zhvillimit të profesionit/sectorit. Rrjedhimisht, është përcaktuar niveli i pragut në mbi 9 punëtorë të regjistruar. Të gjitha ndërmarrjet me mbi 10 punëtorë të regjistruar në regjistrin e ATK-së (që nga 2016) janë përzgjedhur në mostër, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve të zgjedhura kishin 8-9 punëtorë të regjistruar. Është pritur, megjithatë që pragu i madhësisë do të ruhet në këtë mënyrë sepse këto ndërmarrje mund të jenë rritur ndërkohë dhe/ose ato mund të kenë pasur më shumë punëtorë të punësuar jo zyrtarisht. Rrjedhimisht, madhësia e ndërmarrjeve që përfundimisht u anketuan sillet renditet midis 10 dhe 215 punonjës në kohën e anketimit.

Nga këto ndërmarrje të anketuara për qëllimin e këtij studimi, 53 firma janë ndërmarrje të vogla, përkatësisht punësojnë midis 10 dhe 49 punëtorë, ndërsa pjesa e mbetur prej 12 janë të madhësisë së mesme, përkatësisht kanë të punësuar midis 50 dhe 249 punonjës. Veprimtaria më e shquar në mesin e këtyre bizneseve është prodhimi i mobileve, ku produktet kryesore janë kuzhinat montuese dhe orenditë e dhomave të gjumit, pasuar nga tavolina, karrige dhe mobile për kopsht/zyrë. Përveç mobileve, dyert dhe dritaret e drurit janë produkte të zakonshme në mesin e këtyre ndërmarrjeve, pasuar nga dyshemetë prej druri, shkallët dhe produkte të tjera të enterierit prej druri.

Duke pasur parasysh fokusin e studimit, objektivi ka qenë të intervistohen njerëzit brenda ndërmarrjeve që kanë përvojë në mbikëqyrjen e punëtorëve dhe janë të vetëdijshëm për detyrat aktuale dhe të dëshiruara që kryhen dhe aftësitë e nevojshme në mesin e të punësuarve (aktualisht dhe në të ardhmen). Rrjedhimisht janë intervistuar mbikëqyrësit e prodhimit ku ka qenë e mundur (në thuajse një të tretën e ndërmarrjeve), pasuar nga pronarët dhe drejtorët e ndërmarrjeve (shih tabelën 1.2)².

Tabela 1.2: Pozita e të anketuarve

Aktiviteti ekonomik	Ndarja e ndërmarrjeve
Pronar	48%
Menaxher prodhimi/linje	31%
Drejtor	11%
Menaxheri i burimeve njerëzore	5%
Të tjera	5%
Total	100%

Pyetësi i anketës është organizuar në modulet e mëposhtme:

Moduli 1 përbante pyetje lidhur me karakteristikat e firmës duke përfshirë: a), Karakteristikat e firmës, përkatësisht informacionet për aktivitetin ekonomik, investimet, eksportet, punësimin sipas gjinisë, moshës, profesionet; mënyrën e punësimit (i rregullt apo sezonal); vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira; trajnimin); informacione të detajuara për profesionin e zgjedhur (numrin e punonjësve dhe shpërndarjen sipas gjinisë, moshës dhe arsimimit); b) pyetje lidhur me pritjet për të ardhmen, në lidhje me punësimin, qarkullimin, eksportet dhe investimet; c) aspekte të arsimit dhe aftësimit profesional gjegjësisht shqyrtimi i aftësive dhe ofrimi i trajnimit, dhe d) Pyetjet lidhur me statusin dhe fushat e bashkëpunimit ndërmjet sektorit dhe ofertës për punë.

Moduli 2 është fokusuar në detyrat specifike të profesionit për profesionin e zgjedhur. Për secilën prej detyrave specifike të profesioneve, përfshirë nën ISCO-08 përshkrimi për punëtorët konkret,

² Duhet të theksohet se madhësia e ndërmarrjeve në sektor dhe në Kosovë në përgjithësi është relativisht e vogël dhe administrohen nga bizneset familjare. Pronësia dhe menaxhimi, dhe funksione/pozita të ndryshme të menaxhmentit shpesh nuk janë të ndara.

ndërmarrjeve u janë bërë pyetjet në vijim: nëse punëtorët konkret janë duke kryer detyrën aktualisht, nëse ata duhet të kryejnë detyrën; nëse rëndësia e detyrës do të rritet në të ardhmen. Për më tepër, ndërmarrjeve u është kërkuar që t'i listojnë tri aftësi kryesore përkatëse për arritjen e rezultateve të performancës së pritshme. Përveç kësaj janë siguruar të dhëna lidhur me nevojat e paraqitura për aftësitë dhe masat e ndërmarra nga bizneset për adresimin e tyre. Moduli 3 ka mbuluar rëndësinë dhe përgatitjen e punëtorëve në përmbushjen e aftësive gjenerike dhe Moduli 4 përfshin pyetje për historikun e ndryshimeve të mëdha dhe risive të paraqitura në bizneset e intervistuar dhe ndikimin e tyre mbi grupin dominues.

Pjesa tjetër e këtij raporti është organizuar si vijon. Seksioni 2 jep informacione mbi zhvillimet e fundit në sektor dhe perspektivat për të ardhmen, kërkesën për fuqi punëtore dhe ofertën e punës dhe zhvillimin e aftësive. Pjesa 3 diskuton mbi përfundimet e nxjerra nga nevojat e aftësive për profesionin e zgjedhur të punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, me fokus të veçantë në detyrat që kryhen dhe aftësitë e përgjithshme dhe specifike të kërkuara. Pjesa 4 paraqet disa fjali përmbyllëse dhe rekomandime.

2. Pasqyra e sektorit

2.1 Madhësia e sektorit

Besueshmëria e shifrave për madhësinë e sektorit dhe numrin e vendeve të punës që ai ofron është e kufizuar, pjesërisht për shkak të informalitetit të lartë (p.sh. Riinvest, 2013, mbi përhapjen e informalitetit në mesin e ndërmarrjeve formale). Megjithatë, si burimet e të dhënave zyrtare (statistikat kombëtare dhe të dhënat nga Administrata Tatimore, shtjelluar më poshtë) dhe të dhënat parësore të mbledhura nga aktorët e tjerë (donatorët, qeveria) sugjerojnë se përpunimi i drurit është një sektor prodhues në rritje.

Sipas statistikave kombëtare të ASK-së, edhe pse sektori mban më pak se 1 për qind nga vlera e plotë e shtuar bruto (VSHB)³ në ekonomi, VSHB e nën-sektorëve të mbuluar në këtë studim është trefishuar midis 2008 dhe 2013 (Tabela 2.1).

Tabela 2.1: Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) në prodhimin e produkteve të drurit (në mijë Euro)

Kodi NACE	Aktiviteti ekonomik	2008	2009	2010	2011	2012	2013
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës, përveç mobileve; prodhimi i artikujve të kashtës dhe materialeve të thurjes	4,157	10,386	21,404	9,940	12,030	12,038
31	Prodhimi i mobileve*	1,695	3,163	1,926	4,300	8,423	5,309
16+31	Gjithsej në sektorin e përpunimit të drurit	5,852	13,549	23,330	14,240	20,453	17,347
	Total VSHB Ndarja e përpunimit të drurit në total të VSHB-së	3,290,837	3,458,881	3,687,117	3,944,864	4,167,016	4,435,509
		0,2%	0,4%	0,6%	0,4%	0,5%	0,4%


*Kjo përfshin prodhimin e dyshekëve (31.03), sidoqoftë kjo nuk pritet të jetë përgjegjëse për një pjesë të madhe të VSHB-së. Burimet: Total VSHB të dhënat nga ASK (2017); VSHB në nivel sektori nga ASK (cituar në EYE, 2016)

³ Vlera e Shtuar Bruto në çmime bazike është baras me daljet në çmimet bazike, minus konsumit të mesëm në çmimin e blerësit.

Megjithëse përkufizimi i sektorit ndryshon midis studimeve të ndryshme, tregues të ndryshëm tregojnë për një trend pozitiv në këtë sektor në vitet e fundit dhe një pamje pozitive për sektorin në të ardhmen. USAID (2015a) bazuar në intervista me disa prej ndërmarrjeve më të mëdha në këtë sektor, raportohet rritje e fuqishme në vitet e fundit si dhe mundësitë për zgjerimin e mëtejshëm të sektorit si në nivel lokal ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht për karrige, tavolina, kuzhina, kabinete dhe enterierë druri. UNDP dhe MTI (2015) sugjerojnë gjithashtu që ka mundësi të rritjes së eksportit të këtyre sektorëve.

Në vitin 2015 Kosova kishte një deficit tregtar prej 79 milionë € për produkte druri të prodhuara. Megjithatë trende pozitive mund të vërehen sa u përket statistikave të tregtisë së jashtme për sektorin. Vlera e eksporteve është rritur më shumë se dyfishi prej 2.64 milion € në vitin 2010 në 5.46 milion € në vitin 2015, dhe pastaj ka arritur 7.12 milion € në dhjetë muajt e parë të vitit 2016 (shih figurën 2.1)⁴. Gjatë kësaj periudhe raporti i eksportit ndaj importit për produktet e zdrukthëtarisë është rritur vazhdueshëm prej 3.7 për qind në vitin 2010 në 6.5 për qind në vitin 2015 dhe 8.8 për qind në dhjetë muajt e parë të vitit 2016.


Figura 2.1: Eksporti i produkteve dhe mobileve të prodhuara të drurit



Importi po ashtu është rritur gjatë kësaj periudhe, edhe pse në një trend më të ngadaltë, prej 71 milion euro në vitin 2010 në 84.4 milion euro në vitin 2015 (shih figurën 2). Gjatë kësaj periudhe importi i gjysmë produkteve (lustruesve, shpërplakës, iverplakës, etj.) që përdoren nga prodhuesit vendor për përpunim të mëtejshëm është rritur me 40 për qind, ndërsa importi i mobileve dhe pjesëve të mobileve (p.sh. Një grup që përbëhet nga produkte pjesërisht të përfunduara dhe pjesërisht nga gjysmë produkte siç janë dyshekët, jastëkët etj.) është rritur me 8 për qind, gjë që është në pajtim me shpjegimin që prodhimi vendor dhe zëvendësimi i importit janë rritur gjatë kësaj periudhe.

⁴ Vëreni se këto shifra përfshijnë edhe tregtinë e jashtme të dyshekëve dhe shtretërve.

Figura 2.2: Importi i produkteve dhe mobileve të prodhuara të drurit



Trende pozitive të sektorit në vitet e fundit, potencial për zëvendësimin e importit dhe për eksport, dhe intervenime të mbështetur nga donatorët të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit të përpunimit të drurit dhe promovimin e eksportit japin shpresa se sektori do të rritet në vitet e ardhshme.

2.2 Punësimi

Në vitin 2016, ekzistonin 2,670 punëtorë të regjistruar në ndërmarrjet në sektorin e drurit (regjistruar në ATK) siç është përcaktuar në këtë raport, që shënon një rritje prej 23 për qind krahasuar me shifrat krahasuese për fundin e vitit 2012. Megjithatë këto shifra ka të ngjarë të jenë shumë nën vlerën reale duke pasur parasysh nivelin e lartë të informalitetit⁵. Vetëm 65 ndërmarrjet e anketuara kishin të punësuar 2,341 punonjës në kohën e anketës, prej të cilëve 17% janë raportuar si punëtor sezonal.

Burime të tjera në bazë të anketimit të ndërmarrjeve dhe intervistave që i referohen numrit total të të punësuarve (d.m.th., duke përfshirë punësimin informal) tregojnë gjithashtu trend të rritjes së punësimit në këtë sektor. P.sh. MTI dhe UNDP (2014) gjejnë në bazë të të dhënave të studimit që punësimi në qarkun e ndërmarrjeve të anketuara është më shumë se dyfishuar në 2012 krahasuar me vitet e mëparshme, kurse USAID (2015a) bazuar në intervista me disa prej ndërmarrjeve më të mëdha në këtë sektor raporton rritje të fuqishme dhe perspektivë pozitive për periudhën 2012-2017.

Numri mesatar i të punësuarve në ndërmarrjet e anketuara ishte 36, duke përfshirë punëtorët sezonal. Tabela 2.2 më poshtë paraqet mbizotërimin e profesioneve të ndryshme në mesin e ndërmarrjeve të anketuara, edhe pse duhet theksuar se rezultatet nuk janë përfaqësuese të sektorit (shih Shtojcën 1 për një listë të profesioneve kyçe në sektor). Ndërmarrjet e anketuara kanë raportuar së paku një instalues apo operator të makinave të zdrukthëtarisë, dhe profesionet tjera më mbizotëruese ishin mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm dhe montuesit e produkteve të drurit. Megjithatë, të dhënat mbi numrin e të punësuarve sipas profesioneve duhet të trajtohen me

kujdes, duke ditur se profesionet në këtë sektor në Kosovë nuk prirën të jenë si të përkufizuara mirë sikurse ato në klasifikimin ISCO 08 bazuar në analizat e detyrave të kryera. Për shembull, derisa UNDP (2016) gjen që ndërmarrjet përcaktojnë “Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm” si grupin kryesor profesional në atë raport të anketimit, se këta punonjës kryejnë një gamë më të gjerë detyrash sesa ato të parashikuara në klasifikimin ISCO 08 (p.sh. përzgjedhja e drurit/lëndës së parë të duhur për qëllime të ndryshme dhe përgatitjen e tij; kalibrimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen e makinerisë). Po ashtu, në anketën e kryer për qëllimin e këtij studimi, ndërmarrjet tregojnë se punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit u kërkohen gjithashtu aftësitë për të kryer detyrat përtej këtyre detyrave siç parashihen në klasifikimin ISCO 08 (p.sh. montimin e produkteve të drurit, ngjyrosjen e produkteve të drurit, përzgjedhjen e drurit/lëndës së parë të duhur për qëllime të ndryshme, etj.).

Tabela 2,2: Punësimi në mostër sipas profesioneve

Kodi ISCO 08	Profesioni	Ndarja e ndërmarrjeve	Punonjësit*	
			Mesatarja	Rangu
7523	Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit	100%	10.6	1-70
7522	Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm	91%	7.1	1-20
8215	Montuesit e produkteve të drurit dhe produkteve tjera	91%	3.1	1-40
7115	Zdrukthëtarët	55%	5.3	1-20
7521	Përgatitës të drurit	9%	3.0	1-8

**Mesatarja dhe shtrirja e firmave që raportojnë punëtorët e profesionit

Pjesa e punëtorëve gra vetëm në ndërmarrjet e anketuara është vetëm 8.3 për qind. Nga këto, mbi gjysma e tyre janë të angazhuara në shitje, administrimin dhe aktivitete të mbështetjes (p.sh. pastrim) dhe një pjesë tjetër prej 37 për qind janë të angazhuara në prodhim, ku përfshihen profesione me kualifikim të lartë siç janë inxhinierë, projektues, arkitektë.

2.3 Kërkesa e fuqisë punëtore

2.3.1 Kërkesa aktuale e fuqisë punëtore: Vendet e lira të regjistruara

nuk ka të dhëna të besueshme mbi kërkesën aktuale dhe të ardhme të fuqisë punëtore në Kosovë. Statistika për vendet e lira të punës (sipas sektorëve) janë në dispozicion nga Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës, sipas të cilës numri total i vendeve të lira të rregullta në sektorin e përpunimit të drurit të identifikuar nga shërbimet publike të punësimit gjatë të njëjtës periudhë ishte 141 (Tabela 2.3 më poshtë), ndërsa edhe 219 vende pune shtesë u renditën si rezultat i masave aktive të tregut të punës, zbatuar nga Agjencia e Punësimit (që më parë ishte Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale). Megjithatë, në përgjithësi, statistikat e vendeve të lira duhet të trajtohen me kujdes sepse shërbimet publike të punësimit nuk arrijnë të identifikojnë të gjitha vendet e lira të punës për arsye të ndryshme: ndërmarrjet nuk raportojnë vendet e lira; këshilltarët e punësimit mbështeten vetëm në vizitat në terren për të identifikuar vendet e lira (d.m.th., ata nuk përdorin burime tjera të informacionit si portalet private për punë); dhe ndërmarrjet shpesh nuk publikojnë vendet e lira fare, duke zgjedhur që në vend të kësaj të bazohen në kanalet informale të rekrutimit. Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 417 të papunë në profesionet që kanë të bëjnë me sektorin e drurit, prej të cilëve 66, pra rreth 16 për qind janë punësuar me sukses. Masat aktive të tregut të punës kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë aspekt, duke mbuluar gati dy të tretat e punësimeve.

⁵ Në vitin 2013, Instituti Riinvest vlerësoi se në sektorin e prodhimit më pak se 55 për qind e punonjësve të punësuar nga ndërmarrjet janë të regjistruar.

Tabela 2.3: Numri i vendeve të lira, papunësia dhe ndërmjetësimet në punë (janar – shtator 2017)

Të papunët e regjistruar	417
Vende të lira	360
Të rregullta	141
Përmes masave aktive të tregut të punës	219
Ndërmjetësimet në punësim	66
Të rregullta	25
Përmes masave aktive të tregut të punës	41

Burimi: Agjencia e Punësimin e Republikës së Kosovës, 2017

2.3.2 Perspektiva e së ardhmes për kërkesat e fuqisë punëtore

Ndërmarrjet e anketuara për qëllime të këtij studimi parashohin të ardhme të ndritur për sektorin e përpunimit të drurit. Trendet pozitive sa i përket kërkesës për fuqi punëtore në sektorin e përpunimit të drurit pritet të rriten gjatë afatit të mesëm, siç sugjerohet nga disa tregues të mbledhur në nivel firmash nga mostrat e ndërmarrjeve më të mëdha në këtë sektor. Pritjet sa u përket trendeve të punësimin në të ardhmen për profesione të ndryshme janë në përgjithësi pozitive, pa pritje të rënies së punësimin raportuar në ndonjë prej profesioneve. Treguesit për rritjen e trendeve të punësimin janë veçanërisht të forta për profesionet e punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, me 83 për qind e të intervistuarve që parashikojnë një rritje të të punësuarve, ndjekur nga afër nga mobilierët (80 për qind) dhe montuesit e produkteve të drurit (72%) (shih Tabelën 2.4).

Tabela 2.4: Pritjet për punësimin e ardhshëm sipas profesionit


Profesioni	Rritje	Ngjashëm	Rënia	Nuk e di / nuk ka përgjigje
Instaluesit dhe operatorët e makinave të zdrukthëtarisë	83%	17%	0%	0%
Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm	80%	19%	0%	1%
Montuesit e produkteve të drurit dhe produkteve tjera	72%	22%	0%	6%
Zdrukthëtarët	38%	14%	0%	48%
Trajtues të drurit	14%	25%	0%	61%

Pritjet për rritjen e punësimin në këtë sektor janë në përputhje me tregues të tjerë të mbledhura nga anketa. Në pyetjen për perceptimet për të ardhmen e këtij sektori, 83 për qind raportojnë se sektori i po rritet, ndërsa pjesa tjetër pritet që ai të mbetet në një nivel të ngjashëm (me përjashtim të një ndërmarrjeje).

Ndërmarrjet e anketuara ndajnë pritje edhe më pozitive lidhur me aktivitetet e tyre të biznesit për periudhën afatmesme. Pjesa e atyre që presin të rritet qarkullimi i tyre, punonjësit dhe eksportet ndërmjet⁶ 89 dhe 90 për qind (figura 2.3). Firmat tjera kanë tendencë të raportojnë pritjet e aktiviteteve ekonomike të ngjashme dhe punësimin.


⁶ Për eksporte, për mos- eksportuesit, planet për të filluar eksportin janë regjistruar si rritje nëse ndërmarrja aktualisht nuk eksporton.

Figura 2.3: Pritjet për aktivitetet ekonomike në të ardhmen



Këto pritje janë në përputhje me përgjigjet për investimet e së tashmes dhe të së ardhmes. Domethënë, afërsisht 90 për qind e ndërmarrjeve të anketuara raportojnë investime në makineri dhe pajisje, ndërsa rreth 60 raportojnë investime në tokë dhe/apo ndërtesa gjatë dy viteve të fundit (shih figurën 2.4). Qëllimet e raportuara për investime për tri vitet e ardhshme janë ose të ngjashme ose më të larta.

Figura 2.4: Investimet më të reja dhe planet për investime në të ardhmen



2.3.3 Niveli i arsimimit: niveli i zakonshëm dhe i preferuar i arsimimit

Për profesionet e përzgjedhura, ndërmarrjeve u është kërkuar që të tregojnë nivelin e zakonshëm të arsimimit për punonjësit e tanishëm dhe nivelin e preferuar të arsimimit të tyre. Rezultatet përmbledhur në Tabelën 2.5 më poshtë, sugjerojnë ca dallime midis profesioneve, megjithëse arsimiti i mesëm (gjimnazi) dominon në mesin e punëtorëve aktual në të gjitha profesionet⁷. Në përputhje me pritjet, niveli i preferuar i arsimimit është paksa më i lartë se ai i tanishmi, mesatarisht. Megjithatë, gjetja më e spikatur në këtë drejtim është mospërputhja e madhe midis llojit të zakonshëm dhe atij të preferuar të arsimimit të mesëm. Me përjashtim të mobilierëve dhe punëtorëve të ngjashëm, të diplomuarit e nivelit të mesëm profesional janë më të preferuarit për

⁷ Fakti se një pjesë e madhe e firmave që paraqesin arsimimin e nivelit terciar si niveli tipik i arsimimit për mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm është i habitshëm dhe nuk përputhet me gjetjet e UNDP-së (2016). Kjo mospërputhje ka të ngjarë të shpjegohet me një kombinim faktorësh. Duket se ekziston një mbivendosje e detyrave dhe nuk ka ndarje strikte ndërmjet punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit dhe mobilierëve tek disa ndërmarrje. Prandaj, disa punonjës të cilat janë raportuar si mobilierë në UNDP (2016) ka të ngjarë të jenë raportuar si punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit në këtë studim, ndërsa ata që kryejnë edhe detyrat e nivelit më të lartë, të tilla si dizajnerit i produkteve janë raportuar se mobilierë (në përputhje me gjetjet e UNDP-së, 2016 që edhe mobilierët të kryejnë këtë detyrë).

të gjitha profesionet. Dallimet midis llojeve aktuale dhe të preferuara të arsimit janë veçanërisht të mëdha për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit dhe zdrukthëtarët.

Tabela 2.5: Nivelet e zakonshme dhe të dëshiruara të arsimit për punonjësit

	Profesioni/nivelet e arsimit	Niveli i arsimit		Numri i vëzhgimeve
		E zakonshme	E dëshiruar	
Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit				
	Shkollimi fillor	3%	0%	65
	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnaz)	71%	2%	
	Arsimi i mesëm profesional	23%	86%	
	Arsimi terciar	3%	12%	
Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm				
	Shkollimi fillor	2%	0%	58
	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnaz)	24%	2%	
	Arsimi i mesëm profesional	17%	21%	
	Arsimi terciar	57%	77%	
Montuesit e produkteve të drurit dhe produkteve tjera				
	Shkollimi fillor	3%	0%	57
	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnaz)	70%	31%	
	Arsimi i mesëm profesional	27%	60%	
	Arsimi terciar	0%	9%	
Zdrukthëtarët				
	Shkollimi fillor	6%	0%	34
	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnaz)	81%	17%	
	Arsimi i mesëm profesional	11%	83%	
	Arsimi terciar	3%	0%	

Kjo mospërputhje mund të jetë për shkak të një kombinimi faktorësh, duke përfshirë: furnizim të pamjaftueshëm të të diplomuarve nga arsimit i mesëm profesional për këtë sektor (në rajonet ku sektori është më i përqendruar), mungesa e informacionit tek punëdhënësit për shkollat përkatëse, dhe mungesa e kënaqësisë tek punëdhënësit me të diplomuarit nga këto shkolla. Megjithatë, pavarësisht prej arsyeve për mospërputhje, kjo gjetje është e rëndësishme sepse ajo sugjeron se, në kundërshtim me atë që nganjëherë është besuar, punëdhënësit nuk preferojnë aktualisht të diplomuarit në arsimin e mesëm. Nga pikëpamja e politikave, kjo nënkupton se një përmirësim i cilësisë dhe ndërlidhjes (dhe shpërndarja gjeografike) e arsimit të mesëm profesional shoqëruar me informim të efektshëm, si dhe bashkëpunimi me sektorin privat mund të përmirësojnë perspektivën e punësimit për të diplomuarit e arsimit të mesëm.

2.3.4 Vështirësitë në rekrutimin e punëtorëve të aftë

Sikurse mospërputhjet e raportuara më lart, dhe në pajtim me gjetjet nga studimet e mëparshme, vështirësia e rekrutimit të punonjësve me aftësitë e nevojshme për të gjitha profesionet është e përhapur në sektorin e përpunimit të drurit kudo. Tabela 2.6 paraqet pjesën e ndërmarrjeve që janë përbërë me vështirësi në rekrutimin e punonjësve të profesioneve të ndryshme, si dhe numrin e ndërmarrjeve që kanë pasur vende të lira. Nëntëdhjetë e pesë përqind e të gjitha ndërmarrjeve në mostër raportojnë vështirësi për rekrutimin e punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit me aftësitë e nevojshme për punë. Janë raportuar vështirësi edhe në rekrutimin e zdrukthëtarëve dhe mobilierëve, megjithatë këta të fundit janë relativisht më pak të kërkuar në treg (d.m.th. vetëm 34 ndërmarrje kanë pasur vende të tilla të lira, krahasuar me 56 që kishin vende të lira për mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm).

Tabela 2.6: Vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira

Profesioni	Vështirësia në rekrutim	Vëzhgimet (ndërmarrjet me vende të lira)
Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit	95%	65
Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm	80%	56
Montuesit e produkteve të drurit dhe produkteve tjera	66%	56
Zdrukthëtarët	82%	34

2.4 Oferta e fuqisë punëtore dhe zhvillimi i aftësive

Ofrimi i arsimit dhe aftësimin për aftësitë teknike të sektorit specifik për sektorin e përpunimit të drurit është i kufizuar në kuptim të numrit të programeve të ofruara dhe studentëve/vijuesve të regjistruar. Programet ofrohen nga shkollat e mesme profesionale, Qendrat e Aftësimin Profesional të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, dhe Fakulteti i Arkitekturës, Projektimit dhe Teknologjisë së Drurit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

2.4.1 Oferta e fuqisë punëtore nga shkollat e mesme profesionale

Në nivelin e arsimit të mesëm ofrohen dy programe: përpunimi i drurit dhe zdrukthëtaria. Numri i nxënësve të regjistruar në këto profile (total në klasat 10-12) në këto dy vitet akademike të fundit ka vazhduar të brijë, nga 73 në vitin shkollor 2015/16 në 52 në vitin akademik 2016/17 (Tabela 2.7). Kjo është në përputhje me trendin e rënies së numrit të nxënësve dhe profileve të ofruara në vitet e mëparshme (shih EYE, 2016).

Tabela 2.7: Nxënësit në shkollat e mesme profesionale (2015/16 dhe 2016/17)

Profili	2015/16			2016/17		
	Regjistruar / hyrje	Numri i nxënësve/ në dispozicion	Pjesa e femrave	Regjistruar / hyrje	Numri i nxënësve/ në dispozicion	Pjesa e femrave
Përpunimi i drurit	15	40	33%	20	43	33%
Zdrukthëtarë	12	33	3%	7	9	9%
Total	27	73	13%	27	52	19%

Burimi: MASHT (2017)

Shpërndarja e nxënësve në këto profile nëpër shkolla dhe komuna në vitin akademik 2015/16 është paraqitur në Tabelën 2.8 më poshtë. Shpërndarja gjeografike e këtyre profileve/nxënësve nuk duket të jetë në përputhje me shpërndarjen gjeografike të ndërmarrjeve në sektorin e përpunimit të drurit, me përjashtim të profilit të përpunimit të drurit, që ofrohet në shkollën Zenel Hajdini në Ferizaj, ku gjenden një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve (shih profilin e sektorit nga MTI dhe UNDP, 2014).

Tabela 2.8: Shpërndarja e nxënësve (2016/17)

Programi/shkolla	Numri i nxënësve në dispozicion
Përpunimi i drurit	
Zenel Hajdini, Ferizaj	40
Zdrukthëtarë	
Shaban Spahija, Pejë	25
Nënë Tereza, Prizren	6
Nëna Terezë, Mitrovica	2

2.4.2 Oferta e fuqisë punëtore nga qendrat e aftësisit profesional

Qendrat e Aftësisit Profesional të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës ofrojnë trajnime modulare, kryesisht për të papunët e regjistruar. Kurset e trajnimit për zdrukthetari ofrohen Qendrat e Aftësisit Profesional (QAP-të) në Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjilan dhe Doljan. Numri total i pjesëmarrësve të certifikuar në këto QAP është 122 në vitin 2015 dhe është rritur me mbi 40 për qind, duke arritur në 176, në vitin vijues (Tabela 2.9). Rritja e numrit të pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësve të certifikuar erdhi (fillimisht) si rezultat i rritjes së përpjekjeve për përfshirjen e të papunëve të regjistruar në aftësim profesional (dhe masat tjera aktive të tregut të punës) dhe për të rritur përdorimin e programeve ekzistuese fizike dhe kapaciteteve njerëzore brenda QAP-ve dhe mund të pasqyrojë gjithashtu një rritje në numrin e përgjithshëm të personave të papunë të regjistruar në zyrat publike të punësimit.

Tabela 2.9: Pjesëmarrësit në trajnim në QAP në zdrukthetari, 2015 dhe 2016

QAP	2015		2016	
	Numri i personave të trajnuar	Numri i personave të certifikuar	Numri i personave të trajnuar	Numri i personave të certifikuar
Ferizaj	45	38	71	57
Pejë	35	27	57	50
Mitrovicë	32	29	47	39
Gjilan	25	17	29	23
Doljan	15	11	7	7
Gjithsejtë	152	122	211	176

Burimi: MPMS, Raporti vjetor i Punës dhe Punësimit 2015 dhe 2016

2.4.3 Oferta e fuqisë punëtore nga arsimit i lartë

Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në të kaluarën Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, pjesë e Universitetit të Prishtinës) ka ofruar programe të ndryshme të arsimit të lartë lidhur me përpunimin e drurit ndër vite. Programi Bachelor në Arkitekturë Enterieri dhe Dizajn Mobilesh ka filluar të ofrohet në vitin akademik 2014/15 (Teknologji e Drurit dhe Dizajn i Enterierit dhe Teknologji e Drurit kanë qenë programet paraardhëse). Një total prej 54 studentë të diplomuar nga këto programe midis viteve 2012 dhe 2017, ndërsa aktualisht universiteti regjistron rreth 100 studentë çdo vit në programet Arkitekturë e Enterierit dhe Dizajn Mobilesh. Në vitin akademik 2016/17 numri total i studentëve aktiv në këtë program ishte 256, nga të cilët 44 për qind femra (Tabela 2.10).

Tabela 2.10: Studentët në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (2016/17)

Programi	Regjistruar	Numri i përgjithshëm i studentëve	Pjesa e femrave
Arkitektura e Enterierit dhe Dizajni i Mobileve	116	256	44%

Burimi: Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit (2017)

2.4.4 Zhvillimi i aftësive në ndërmarrje

Duke pasur parasysh vështirësitë në rekrutimin e kandidatëve dhe mospërputhjen ndërmjet arritjeve aktuale dhe të dëshiruara arsimore të punëtorëve, nuk është për tu habitur se të gjitha ndërmarrjet e anketuara raportojnë se ata ofrojnë aftësimin fillestar në punë për punëtorët e rinj. Kohëzgjatja e raportuar e trajnimit sillet në mes të 1-12 muaj, me një mesatare prej 4 muajsh; sidoqoftë, dy të tretat e ndërmarrjeve ofrojnë një trajnim fillestar prej 1-3 muaj.

Ndërmarrjet po ashtu ofrojnë trajnim për punëtorët aktual. Rreth një në dhjetë prej ndërmarrjeve të anketuara raportojnë se ata nuk rishikojnë aftësitë e punëtorëve të tyre. Shumica e ndërmarrjeve (83 për qind) shqyrtojnë rregullisht aftësitë e disa grupeve të punëtorëve, derisa 6 të tjera shqyrtojnë aftësitë e të gjithë punëtorëve. Vetëm pak më shumë se një e treta e ndërmarrjeve të anketuara raportojnë se gjatë vitit 2016 (disa prej) punëtorëve të tyre kanë marrë pjesë në ndonjë kurs trajnimi të jashtëm apo të brendshëm që pjesërisht apo plotësisht janë paguar nga ndërmarrjet. Megjithatë kur u është kërkuar të renditin lloje specifike të zhvillimit të aftësive, gati të gjitha ndërmarrjet raportojnë trajnime jo formale në kuadër të punës (d.m.th. Periudha të planifikuara të trajnimit, udhëzime apo përvojë praktike në vendin e punës) (Tabela 2.11)⁸. Trajnimet e jashtme (trajnimet e ofruara nga ofrues të tjerë, d.m.th. jashtë ndërmarrjes) është forma tjetër më mbizotëruese e trajnimit, që ofrohet nga rreth një në pesë ndërmarrje. Forma të tjera të trajnimit të brendshëm të tilla si qarqet e mësimit (p.sh. grupet e personave të punësuar që mbledhen rregullisht me qëllimin kryesor që të mësojnë më shumë për kërkesat e organizatës së punës, procedurat e punës dhe vendet e punës) dhe qarqet e cilësisë (puna në grupe me qëllim të zgjidhjes së problemeve të prodhimit dhe vendeve të punës nëpërmjet diskutimit) ofrohen nga 15 dhe 9 për qind e ndërmarrjeve, përkatësisht.

Tabela 2.11: Ofrimi i trajnimit

Lloji i trajnimit	Ndarja e ndërmarrjeve
Trajnimit në punë	99%
Qarqet e mësimit	15%
Qarqet e cilësisë	9%
Trajnimit i jashtëm	19%

2.4.5 Bashkëpunimi ndërmjet punëdhënësve dhe ofruesve të arsimit dhe trajnimit

Në bazë të rezultateve të anketës, ekziston një bashkëpunim ndërmjet ndërmarrjeve më të mëdha të përpunimit të drurit me⁹ ofruesit e arsimit dhe trajnimit. Bashkëpunimi mes ndërmarrjeve të përpunimit të drurit dhe shkollave të mesme profesionale është më i përhapur, me mbi 40 për qind të ndërmarrjeve që raportojnë se kanë pranuar praktikantë apo studentë nga këto shkolla derisa mbi 20 për qind raportojnë se kanë kontribuar në zhvillimin e kurrikulës në këto shkolla (shih Tabelën 2.12 më poshtë). Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në drejtim të mbajtjes së praktikës dhe vizitave të studentëve është disi më i ulët, gjë që mund të reflektojë në numrin e kufizuar të programeve dhe studentëve që janë relevant për këtë sektor, megjithatë një pjesë e ngjashme e ndërmarrjeve (p.sh., një në pesë) kanë kontribuar në zhvillimin e kurrikulës për programe të tilla. Bashkëpunimi me qendrat e aftësisit profesional është ende i ulët, por ai ndjek modele të ngjashme me marrjen e praktikantëve si mënyra më e përmendur e bashkëpunimit, pasuar nga vizitat e pjesëmarrësve të trajnimit dhe zhvillimi i kurrikulës.

Tabela 2.12: Bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve dhe ofruesve të arsimit dhe trajnimit

Institucioni/lloji i bashkëpunimit	Ndarja e ndërmarrjeve
Shkollat e mesme profesionale	
Praktikantët e pranuar	42%
Ka kontribuar në zhvillimin e kurrikulës	22%
Pranon vizita nga studentët	43%
Arsimi terciar	0%

⁸ Këto ka të ngjarë që nuk janë raportuar në trajnimin e përgjithshëm lidhur me trajnimin për shkak të kualifikimit në fjalë, d.m.th. Që trajnimi "të paguhet pjesërisht apo plotësisht nga ndërmarrjet."

⁹ Vëreni se anketa nuk është përfaqësuese, por ajo mbulon disa prej ndërmarrjeve më të mëdha në sektor.

Qendrat e Aftësimit Profesional	
Ka pranuar pjesëmarrës trajnimi në punë	28%
Ka kontribuar në zhvillimin e kurrikulës	17%
Pranon vizita nga pjesëmarrësit e trajnimit	20%
Të tjera	2%
Institucionet e arsimit të lartë	
Praktikantët e pranuar	30%
Ka kontribuar në zhvillimin e kurrikulës	20%
Pranon vizita nga studentët	23%
Të tjera	6%

Në pyetjen lidhur me interesimin e tyre për të bashkëpunuar me ofruesit e arsimit dhe trajnimit, pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve të anketuara thonë se ata janë të interesuar të bashkëpunojnë në një apo më shumë nga format e mëposhtme: pranimi i praktikantëve ose vizitave nga studentët (praktikantët), si dhe kontributi në zhvillimin e kurrikulës.

3. Nevoja e aftësive për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit

3.1 Pasqyrë e profesionit

Sipas klasifikimit ISCO-08, punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit rregullojnë dhe operojnë si dhe monitorojnë makinat automatike apo gjysmë automatike, të tilla si sharrat precize, makinat për formësim, rrafshim, shpim, rrotullim dhe gdhendje për të përpunuar apo riparuar pjesët e drurit për mobile, aksesore dhe produkte të tjera të drurit.

Ndërmarrjet e anketuara raportojnë se 29 për qind e punonjësve të tyre aktualisht kryejnë së paku një nga detyrat e punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit. Duhet të theksohet, megjithatë, se këto shifra duhet të trajtohen me kujdes sepse (i) ky studim nuk është përfaqësues për të gjithë popullatën, pra ai përqendrohet në ndërmarrjet më të mëdha në përpunimin e drurit në Kosovë, dhe (ii) ky profesion nuk duket të jetë saktësisht sipas përkufizimit të klasifikimit ISCO 08 dhe janë gjetur mbivendosje veçanërisht në mes të këtij profesioni dhe të atij të mobilierëve dhe punëtorë të ngjashëm (siç sugjerohet nga gjetjet e këtij studimi dhe ato të UNDP-së, 2016). Pavarësisht nga këto të dhëna, për aspektet praktike është e mjaftueshme të dihet përhapja e detyrave që lidhen me instalimin dhe operimin e makinave dhe veglave të zdrukthëtarisë dhe veçanërisht përhapja e përdorimit të makinerive CNC. Rezultatet e anketës konfirmojnë se makinat CNC po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për këtë sektor, me katër nga pesë ndërmarrje të vogla dhe të mesme të anketuara që raportojnë për përdorimin e tyre. Para diskutimit të detyrave të kryera nga punonjësit e këtij profesioni dhe kërkesat për aftësi, në vijim ofrohet një profili demografik i të punësuarve.

Më shumë se gjysma e të punësuarve në këtë grup profesionale është nën moshën 30 vjet (shih Tabelën 3.1). Kjo shpjegohet pjesërisht nga fakti se përpunimi i drurit nuk ka qenë një nga sektorët kryesorë të prodhimit gjatë periudhës socialiste, pra punëtorët më të vjetër me aftësi të përpunimit të drurit nuk janë aq të përhapur (krahasuar me punëtorët e tekstit, për shembull) dhe sektori ka pësuar ndryshime të theksuara teknologjike në ndërkohë. Në të njëjtën kohë, rritja e përdorimit të makinave CNC ka të ngjarë të bëjë këtë sektor më tërheqës për punonjësit më të rinj të cilët janë më shumë të prirë dhe/ose të interesuar për të punuar me makineri të kompjuterizuar.

Tabela 3.1: Punësimi sipas moshës

Mosha e punëtorëve	Shpërndarja
Nën 30	54%
31-49	26%
50 e më lart	20%

Ky është një profesion i dominuar nga meshkujt, e që njëjtë tentohet të jetë me operatorët e makinave edhe në vende të tjera. Pjesa e punëtorëve gra në këtë grup profesional është vetëm 7 për qind. Futja e makinerive CNC mund të çojë në praninë më të lartë të femrave siç sugjerohet nga përvojat e vendeve të tjera (p.sh. WMC, 2008).

3.2 Detyrat dhe aftësitë specifike profesionale

Tabela 3.2 në vijim përmbledhë detyrat e kryera nga punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, renditur sipas rëndësisë së tyre gjithnjë në rritje në të ardhmen, siç raportohet nga ndërmarrjet e anketuara. Përgjithësisht, detyra që lidhen me këtë profesion ka shumë të ngjarë të bëhen të një rëndësie në rritje në të ardhmen.

Instalimi, programimi, operimi dhe monitorimi i makinave të zdrukthëtarisë përmendet më së shpeshti si dhe është detyra që ka më së shumti të ngjarë të vlerësohet si gjithnjë e më e rëndësishme (shih po ashtu diskutimin më poshtë për informata më të hollësishme për detyra të ndryshme brenda kësaj detyre). Duke pasur parasysh rëndësinë në rritje të makinerive CNC

për sektorin dhe mangësitë e aftësive të identifikuar paraprakisht për operatorë të makinerive CNC, ndërmarrjet janë pyetur më tej për këtë lloj të makinerisë në veçanti. Katër nga pesë ndërmarrje kanë raportuar se punonjësit e këtij grupi operativ përdorin makineri CNC. Leximi dhe interpretimi i specifikimeve ose ndjekja e udhëzimeve verbale, përzgjedhja, instalimi dhe përshtatja e teheve, kokave prerëse, etj. janë detyra tjera shumë të zakonshme për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit. Instalimi dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinave të zdrukthëtarisë për operim nga të tjerët, nga ana tjetër, është një detyrë më pak e zakonshme, që raportohet nga më pak se gjysma e ndërmarrjeve të anketuara, gjë që nuk është befasisht duke marrë parasysh madhësinë e ndërmarrjeve dhe faktin se ato kryesisht ofrojnë produkte me porosi më shumë sesa prodhimi serik.

Përveç detyrave aktuale të kryera, ndërmarrjet janë pyetur nëse ndonjë prej këtyre detyrave (apo të tjera) duhet të kryhen nga punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit në mënyrë që të mbulohet ndonjë zbraçeti midis detyrave aktuale dhe të preferuara, p.sh. për shkak të mungesës së aftësive, por përgjigjet nuk japin ndonjë dallim.

Tabela 3.2: Detyrat e kryera dhe rëndësia e tyre në të ardhmen

Detyra	Kryhet aktualisht	Duhet të kryhen	Rëndësia në rritje (vërejtjet)
Instalimi, programimi, operimi dhe monitorimi i disa llojeve të makinave të zdrukthëtarisë sharritje, shpim, rrafshim, presim, rrotullim, bluarje apo gdhendje për prodhimin apo riparimin e pjesëve të drunjtë të mobileve, aksesorëve dhe produkteve tjera nga druri	99%	100%	98% (64)
<i>Operimi me makineri CNC</i>	79%	80%	98% (54)
Leximi dhe interpretimi i specifikimeve apo ndjekja e udhëzimeve verbale	85%	86%	95% (56)
Instalimi dhe rregullimi i teheve, kokave prerëse, pjesëve shpuese dhe rripave apo shiritave për sharrim dhe përdorimi i veglave të dorës dhe rregullat	94%	95%	93% (62)
Përzgjedhja e thikave, teheve, sharrave, kokave prerëse, burgive, rripave sipas pjesëve për përpunim, funksioneve të makinave dhe specifikimet e produkteve	89%	89%	93% (58)
Instalimi dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinave të zdrukthëtarisë për operim nga të tjerët	42%	43%	92% (30)

Aftësitë dhe njohuritë e raportuara nga punëdhënësit që kërkohen për kryerjen e këtyre detyrave prirën të jenë të ngjashme në të gjitha detyrat, prandaj ato të gjitha bashkërisht janë paraqitur në kutinë 3.1 më poshtë, ndërsa disa sqarime shitesë mbi aftësitë e kërkuara për detyra të ndryshme janë dhënë më poshtë. Edhe pse aftësitë e përgjithshme janë diskutuar përsëri në veçanti në nën-seksionin e radhës, disa aftësi kryesore të përgjithshme që janë të lidhura me detyrat specifike të profesionit janë paraqitur gjithashtu dhe diskutuar këtu.

Është e rëndësishme të theksohet se megjithëse respondentët në anketë nuk tregojnë dallime ndërmjet situatës aktuale dhe të preferuar (Tabela 3.2 më sipër), një analizë e përgjigjeve lidhur me aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave të punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, së bashku me miratimin dhe të dhënat e mëtejme nga intervistat e hollësishme me ndërmarrjet tregojnë një tablo tjetër. Domethënë brenda detyrës së parë të specifikuar në ISCO, p.sh. "Instalimi, programimi, operimi dhe monitorimi i disa llojeve të makinave të zdrukthëtarisë sharritje, shpim, rrafshim, presim, rrotullim, bluarje apo gdhendje për prodhimin apo riparimin e pjesëve të drunjtë të mobileve, aksesorëve dhe produkteve tjera nga druri", Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit në Kosovë zakonisht janë të kufizuar në operimin me makineri dhe monitorimin e operimit me makineri. Këta punëtorë nuk

kryejnë detyra të tjera të tilla si rregullimi i makinerisë, caktimi i shpejtësisë optimale për operim,¹⁰ mirëmbajtje dhe inspektim të rregullt për diagnostikimin e defekteve bazike. Këto kërkesa shitesë për detyra dhe aftësi janë në linjë me kërkesat për aftësi për instaluesit dhe operatorët e makinave të zdrukthëtarisë në vende të tjera (p.sh. shih standardin profesional për operatorët e makinave CNC në Kanada (WMC, 2008) ose vendet e lira të punës në shumë vende të tjera) dhe janë jashtëzakonisht të rëndësishme për konkurrencën e ndërmarrjeve. Mungesa e mirëmbajtjes së rregullt, për shembull, shkakton prishje të panevojshme të makinave, duke imponuar kështu ndërprerje në procesin e prodhimit dhe angazhimin e teknikëve të riparimit të kushtueshëm nga vende të tjera. Në anën tjetër, aftësitë e programimit nuk janë të nevojshme për të gjithë punonjësit, ndonëse kjo do të ishte e dëshirueshme për disa nga punonjësit më të avancuar¹¹.

Kutia 3.1: Instaluesit dhe operatorët e makinave të zdrukthëtarisë: Aftësitë dhe njohuritë e nevojshme

Aftësitë e leximit dhe gjuhët e huaja

- Leximi i materialeve siç është udhëzimi për përdorues të makineritë në anglisht (ose gjermanisht) në esenciale në mënyrë që të mësohet se si të rregullohet makineria dhe si kryhet mirëmbajtja bazike (p.sh. për zbulimin e gjendjes së veglave, për të ndryshuar vajin rregullisht për të kalibruar makinerinë etj.).

Aftësitë matematikore

- Aftësitë në matematikën elementare (mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi, etj.) dhe gjeometria për qëllime të logaritmit të prodhimit të materialeve.
 - Kuptimi i gjeometrisë bazë është i nevojshëm veçanërisht për vizualizim se si pjesët e drurit do të përshtaten me njëra tjetrën për krijimin e objekteve tre-dimensionale (p.sh. një pjesë e mobileve).

Aftësitë teknike

- Aftësia për t'i kuptuar dhe interpretuar vizatimet e dizajnit dhe specifikimet e modelit.

Të menduarit kritik

- Përdorimi i logjikës dhe arsytimit për të identifikuar përparësitë dhe dobësitë e zgjidhjeve alternative, konkluzioneve dhe qasjeve të problemeve.

Aftësitë kompjuterike

- Leximi dhe redaktimi i kodit konsiderohet e dëshirueshme për operatorët më të avancuar, por jo për shumicën e punëtorëve.
- Njohuritë e softuerit janë të dëshirueshme: Softueri CAD (Computer Aided Design) që përdoret për dizajnimin e pjesëve, CAM (Computer Aided Manufacturing) program që përdoret për të konvertuar vizatimin CAD në G-Code për kontrolluesin e makinës. P.sh. disa programe kanë të shënuar AutoCad (woodCAM|CAD), ArchiCad, ArtCAM.

Njohja e zdrukthëtarisë

- Njohuritë për llojet dhe veçoritë e lëndës së parë.
- Njohuritë për teknikat elementare të zdrukthëtarisë, mjetet dhe pajisjet.

Njohuritë për proceset e makinave CNC dhe komponentët

- Njohuritë për makinat dhe mjetet, pjesët e tyre dhe funksionet.
- Aftësia për të monitoruar treguesit për të siguruar se makineria punon siç duhet.
- Aftësia për të paracaktuar shpejtësinë optimale të makinës dhe parametrat tjerë, si dhe për të bërë kalibrimin.
- Aftësia për të kryer mirëmbajtjen themelore dhe diagnostikimin e defekteve.

Analiza e kontrollit të cilësisë

- Kryerja e inspektimeve të pjesëve të makinave për t'u siguruar që ato plotësojnë specifikimet e skicës dhe cilësinë e nevojshme.
 - Njohuria për përdorimin e instrumenteve matëse precize dhe aplikimin e këtyre instrumenteve (p.sh., noniusët, mikrometrat, etj.) është e dëshirueshme.

¹⁰ Ndërkohë që ndërmarrjet në anketa kanë vënë në dukje se punonjësit kryejnë kalibrim, është konstatuar se ajo çfarë ata i janë referuar është vetëm kalibrimi që kryhet automatikisht nga makina (p.sh. për shkak të ndryshimit të temperaturave apo lagështisë), por jo kalibrimit në rast se preket pozicionimi i veglave, p.sh., nga goditjet dhe kur kërkohen intervenimet e jashtme në softuer.

¹¹ Në anketë, shumë ndërmarrje kanë përmendur 'aftësitë e programimit' si kërkesë, sidoqoftë më vonë është konstatuar se është e zakonshme për dhënie të udhëzimeve të thjeshta për makina CNC që ato të ndiqen i janë referuar si 'programim'.

3.2 Aftësitë e përgjithshme

Tabela 3.3 më poshtë paraqet kërkesat e disa nga aftësitë kryesore të përgjithshme për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, renditur sipas gjasave për rëndësinë e tyre në rritje, siç raportohet nga e ndërmarrjet e anketuara.

Përdorimi i kompjuterëve është i përhapur dhe shkathtësitë kompjuterike janë po ashtu ato që kanë më shumë gjasa që rëndësia e tyre të rritet për detyrat që lidhen me këtë profesion (shih Tabelën 3.3 më poshtë). Pothuajse një e treta e ndërmarrjeve raportojnë se aftësitë e avancuara të tilla si programimi i softuerit janë një kërkesë, megjithatë, siç është shpjeguar më parë, kjo shifër për kërkesat e programimit softuerik duhet të trajtohen me kujdes sepse, siç është shpjeguar në nën-seksionin paraprak, ofrimi i udhëzimeve për makineri CNC duket shpesh të i referohet 'programimit' operativ. Një tjetër në pesë ndërmarrje më tej përmendin aftësi komplekse siç është dizajni me ndihmë kompjuterike si një kërkesë.

Në kuptim të rritjes së rëndësisë në të ardhmen, aftësitë kompjuterike ndiqen me aftësi numerike, të cilat prirën të kufizohen në llogaritjet e thjeshta si mbledhja, pjesëtimi, mesataret, përqindjet etj, por kërkohen në mënyrë universale në mesin e punonjësve në këtë profesion. Siç është shpjeguar në nën-seksionin paraprak, gjeometria bazike është e nevojshme veçanërisht për vizualizim se si pjesët e drurit do të përshtaten me njëra tjetrën për krijimin e objekteve tre-dimensionale (p.sh. një pjesë e mobileve).

Aftësi të zgjidhjes së problemeve dhe komunikimit në një gjuhë të huaj janë gjithashtu në rritje të rëndësisë, ndonëse rëndësia aktuale e tyre ndryshon.

Tabela 3.3: Kërkesat për aftësi kyçe të përgjithshme, rëndësia e tyre në të ardhmen dhe përgatitja e të diplomuarve

Aftësitë e kërkuara	Niveli i kërkuar / rëndësia	Rritja e rëndësisë	Përgatitja e të diplomuarve*
Përdorimi i kompjuterëve			
Elementare (p.sh. Futja e të dhënave, dërgimi dhe pranimi i e-mailave, shtypja)	31%	85%	28%
Mesatare (p.sh. Procesimi i fjalëve apo listat në excel)	14%		
Komplekse (p.sh. Analizimi i informacioneve apo dizajni, duke përfshirë dizajnin me ndihmën e kompjuterit; përdorimi i pakove të analizave statistikore)	19%		
Avancuar (p.sh. Programimi softuerik, menaxhimi i rrjeteve kompjuterike)	31%		
Nuk ka	5%		
Përdorimi dhe të kuptuarit e të dhënave numerike apo statistikore			
Llogaritjet e thjeshta (mbledhja, pjesëtimi, shumëzimi)	51%	71%	48%
Llogaritja e mesatareve, aksioneve, përqindjet, etj.	32%		
Njohja e llogaritjeve të avancuara, metoda statistikore, etj.	14%		
Zhvillimi i modeleve, treguesit e performancës, llogaritjet komplekse	2%		
Nuk ka	1%		
Komunikimi në gjuhë të huaj			
Shumë i rëndësishëm	37%	60%	40%
Mjaft e rëndësishme	37%		
të parëndësishme	26%		
Zgjidhja e problemeve komplekse			
Shumë i rëndësishëm	51%	59%	27%
Mjaft e rëndësishme	46%		
të parëndësishme	3%		
Aftësitë e leximit			
		49%	57%

Leximi i udhëzimeve, instruksioneve dhe teksteve të thjeshta	63%		
Leximi i teksteve specifike të profesionit me ca përmbajtje teknike	25%		
Leximi me të kuptuarit e teksteve komplekse të cilat janë të rëndësishme për punë	9%		
Leximi i përmbajtjes komplekse nga një kontekst më i gjerë	0%		
Nuk ka	3%		
Aftësitë e shkrimit			
Shkrimi i teksteve të thjeshta, plotësimi i formularëve, hartimi i raporteve të shkurtra për veprimet vetanake	65%	26%	77%
Shkrimi i teksteve të cilat përshkruajnë përmbajtjen specifike të njohur të profesionit	15%		
Shkrimi i teksteve specifike dhe komplekse të profesionit	3%		
Shkrimi i analizave, raporteve të cilat vlerësojnë kontekstin më të gjerë të biznesit	2%		
Nuk ka	15%		

*Në mesin e ndërmarrjeve të cilat raportojnë rritjen e rëndësisë së aftësisë

Dy të tretat e ndërmarrjeve raportojnë se punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit zakonisht u kërkohen aftësi themelore të leximit, p.sh. Leximi i udhëzimeve të thjeshta, tekste specifike për profesionin me përmbajtje teknike, dhe nganjëherë leximin dhe kuptimin e teksteve komplekse që lidhen me profesionin. Megjithatë, siç është shpjeguar në nën-seksionin paraprak, aftësia për të lexuar materiale specifike për profesionin siç është doracaku për përdorues të makinerisë ose burime të tjera online në anglisht (apo nganjëherë gjermanisht), duhet të jenë një kusht thelbësor për të paktën disa nga më shumë punëtorë që do të mundësojë atyre të kryejnë të gjitha detyrat e nevojshme, në përputhje me standardet profesionale të vendeve të tjera (p.sh. WMC, 2008).

Kërkesat për shkrim janë disi më pak mbizotëruese, rëndësia e tyre ka relativisht më pak të ngjarë të rritet në të ardhmen, si dhe niveli i kërkuar nuk është tipik kompleks, pra ai zakonisht përfshin shkrim tekstesh të thjeshta, duke plotësuar formularët, shkruar tekste të cilat përshkruajnë përmbajtjen e njohur specifike të profesioneve.

Në aspektin e përgatitjes së punonjësve që vijnë nga sistemi arsimor (qoftë i mesëm apo terciar), ndërmarrjet prirën të kenë një nivel të ulët të kënaqshmërisë. Niveli i ulët i kënaqshmërisë me aftësi kompjuterike dhe aftësi të zgjidhjes së problemeve është veçanërisht shqetësues, duke pasur parasysh rëndësinë e lartë dhe në rritje për këtë profesion. Nga ana tjetër, kënaqshmëria është relativisht më e lartë me aftësitë e shkrimit dhe leximit, pasuar nga aftësitë numerike dhe të komunikimit në një gjuhë të huaj.

Aftësi tjera të përgjithshme që janë të rëndësishme dhe rëndësia e tyre në rritje janë puna ekipore, pavarësia e punëtorëve (d.m.th. kryerja e detyrave në mënyrë të pavarur), mësimdhënia/dhënia udhëzime të tjerëve, përshtatja ndaj pajisjeve apo materialeve të reja (Tabela 3.4).

Tabela 3.4: Kërkesat tjera për aftësi të përgjithshme dhe rëndësia e tyre në të ardhmen

Aftësitë	Shumë/mjaft e rëndësishme	Rritja e rëndësisë
Puna ekipore	100%	90%
Pavarësia	95%	85%
Mësimdhënia/udhëzimi	100%	83%
Përshtatja me pajisje apo materiale të reja	100%	82%
Zhdërvjelltësia manuale	89%	72%

Minimizimi i përdorimit të lëndëve të para, energjisë dhe ujit	97%	62%
Kreativiteti/inovacioni	82%	57%
Komunikimi	48%	22%
Shitjet	34%	22%
Caktimi i objektivave dhe planifikimi i burimeve	23%	17%

3.3 Inovacionet, shtytësit e ndryshimit dhe adresimi i nevojave të paraqitura për aftësi

Dyzet e pesë për qind e ndërmarrjeve të anketuara përmendin profesionin e punëtorit për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit si profesioni që është më i prekuri nga ndryshimet në mesin e grupeve të punëtorëve që ata punësojnë, ndërsa tri të katërtat pajtohen me deklaratën që ky është ndër profesionet më të prekura. Ndryshimet në detyrat e grupit të këtij profesioni duket se nxiten nga risitë, të cilat janë të përhapura tek firmat e anketuara.

Vetëm dy prej 65 ndërmarrjeve të anketuara nuk kanë raportuar inovacione në dy vitet e mëparshme. Shumica e ndërmarrjeve janë angazhuar në inovacione në prodhim, pasuar nga risitë në proceset e prodhimit dhe praktikata e organizatës së punës (Tabela 3.5). Ndër këto ndryshime në proceset e prodhimit dhe futja e produkteve të reja/përmirësuara kanë qenë shtytësit kryesorë të ndryshimeve në kuptim të detyrave që kryhen nga punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit.

Tabela 3.5: Aktivitetet inovative dhe ndikimi i tyre në detyrat që kryhen

Inovacioni	Ndarja e ndërmarrjeve	Ndikimi në profesion*
Produktet e reja/të përmirësuara	95%	84%
Proceset e prodhimit të produkteve të reja/përmirësuara	88%	91%
Praktikat e reja/të përmirësuara të organizatave të punës	74%	35%
Metodat e reja/të përmirësuara të shitjes dhe marketingut	45%	14%

*Në mesin e ndërmarrjeve që raportojnë angazhim në aktivitetin përkatës

Rreth 70 për qind e ndërmarrjeve gjithashtu kanë raportuar ndryshime lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Prej tyre, 43 për qind kanë raportuar se këto ndryshime kanë ndikuar në detyrat e kryera nga punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit.

Trajnimi i stafit ekzistues është mjeti më i zakonshëm i adresimit të nevojave të paraqitura për aftësi në këtë grup profesioni, që përdoret nga tri të katërtat e firmave të anketuara. Në pyetjen nëse ata hasin në vështirësi në gjetjen e trajnerëve apo kurseve të trajnimit për aftësi të tilla, rreth 1 në 5 ndërmarrje raportojnë të jenë ballafaquar me vështirësi, derisa ato të tjerat ose nuk raportojnë asnjë vështirësi apo nuk i dinë (ose nuk kanë kërkuar trajnim). Riorganizimi i brendshëm i stafit dhe rekrutimi i personelit të ri janë mjete tjera të adresimit të nevojave të paraqitura për aftësi (përdorur nga 19 dhe 14 për qind e ndërmarrjeve, përkatësisht).

3.4 Kushtet e punës dhe gatishmëria fizike

Sipas ndërmarrjeve të anketuara, puna e punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit kryhet në ambiente të mbyllura dhe të zhurmshme dhe hapësirat punuese nganjëherë mund të jenë të ngrohta apo të ftohta, me aroma apo dridhje. Në aspektin e përgatitjes fizike të punonjësve, qëndrimi në këmbë, ecja, qëndrimi në gjunjë, etj. janë aktivitete të zakonshme që kërkohen (raportuar nga 80 për qind e ndërmarrjeve), pasuar nga lëvizjet e koordinuara me sy dhe dorë dhe forca fizike (raportuar nga 31 dhe 25 për qind e ndërmarrjeve, respektivisht).

4. Konkluzione dhe rekomandime

Të dhënat dytësore dhe analiza të mëparshme të sektorit të përpunimit të drurit në Kosovë flasin për një rritje të sektorit, me potencial për zgjerimin e mëtejshëm si në tregun vendas ashtu edhe në tregjet e eksportit. Ndërmarrjet e anketuara, e që janë disa prej ndërmarrjeve më të mëdha në këtë sektor, shprehin optimizëm në lidhje me tendencat e ardhshme për punësim, rritje dhe eksport. Në përputhje me këto shpresa, shumë prej tyre raportojnë investime të kohëve të fundit dhe të planifikuara në toka, ndërtesa dhe makineri.

Kërkesa për fuqi punëtore duket të jetë në rritje, me profesionet më të përhapura aktualisht dhe që kanë më së shumti të ngjarë të rriten në të ardhmen, veçanërisht, punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm, dhe montuesit e produkteve të drurit dhe produkteve tjera. Megjithatë, këto profesione janë edhe ato për të cilat ndërmarrjet ka më shumë të ngjarë të raportojnë vështirësi për plotësimin e vendeve të lira të punës me punonjës me kualifikimet e duhura, me vështirësitë për plotësimin e vendeve me punëtorë për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit e që janë më të zakonshmet thuajse në të gjitha ndërmarrjet e anketuara. Profesionin e punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit konsiderohet gjithashtu të jetë në mesin e atyre - nëse jo i vetmi - që më së shumti preket nga ndryshimet në këtë sektor, ku ndryshimet kryesisht nxiten nga futja e proceseve dhe produkteve të reja apo të përmirësuara.

Ekziston një ndryshim i shënuar në mes të nivelit dhe llojit të arsimit të stafit aktual të punësuar dhe preferencave të punëdhënësve. Domethënë, derisa të diplomuarit në arsimin e mesëm të përgjithshëm janë më të zakonshmit në mesin e të gjitha profesioneve, punëdhënësit theksojnë preferencat e tyre për punësimin e më shumë të diplomuarve nga arsimit i mesëm profesional (dhe më shumë të diplomuar nga universiteti, në disa raste). Kjo mospërputhje mund të shkaktojë ulje të produktivitetit të fuqisë punëtore dhe kosto shtesë për ndërmarrjet që duhet të ofrojnë trajnimet në punë për punonjësit e sapo punësuar.

Nga ana e ofertës, ofruesit e aftësive specifike të sektorit janë disa shkolla të mesme profesionale që ofrojnë profilet e përpunimit të drurit apo zdrukthëtarisë, pesë qendra të aftësisimit profesional të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës të cilat ofrojnë trajnime modulare të shkurtra, kryesisht për individët apo të papunët e regjistruar, Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Në vitin 2016, numri i nxënësve në arsimin që lidhet me përpunimin e drurit ishte 52, ndërsa numri i kandidatëve të certifikuar nga qendrat e aftësisimit profesional dhe numri i studentëve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në programin bachelor në Arkitekturë Enterieri dhe Dizajn i Mobileve ishte më i lartë (në 176 dhe 256 respektivisht). Në vitet e fundit, është vërejtur një prirje rënëse në regjistrim në shkollimin e mesëm profesional, por një rritje në arsimin e lartë dhe në qendrat e aftësisimit profesional. Megjithatë, ndërmarrjet në qendrën e përpunimit të drurit nuk duken veçanërisht të kërkojë të diplomuarit e këtyre institucioneve, dhe furnizimi me arsimin e mesëm përkatës veçanërisht është i kufizuar dhe jo në përputhje me shpërndarjen gjeografike të këtyre profileve, gjë që nuk është në përputhje të plotë me shpërndarjen e ndërmarrjeve në sektor.

Vetë ndërmarrjet luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive specifike për profesionin. Të gjitha ndërmarrjet e anketuara ofrojnë aftësim fillestar në punë për punonjësit e rinj, që zakonisht zgjatë 1-3 muaj, dhe trajnimi i punonjësve ekzistues është po ashtu diçka e zakonshme. Trajnimi në vend të punës është mundësuar nga të gjitha ndërmarrjet gjatë vitit 2016 (që do të mund të shpjegohet pjesërisht nga mbizotërimi i lartë i trajnimit fillestar). Format e tjera të trajnimit, trajnimi i jashtëm, qarqet e mësimi dhe qarqet e cilësisë gjithashtu janë raportuar, edhe pse ato nuk janë aq të përhapura.

Ekziston një bashkëpunim ndërmjet ndërmarrjeve më të mëdha të përpunimit të drurit dhe ofruesve të arsimit dhe aftësisimit, me pjesën e ndërmarrjeve të anketuara që raportojnë bashkëpunim me institucione të tilla që sillen në rreth 30 për qind (për institucionet e arsimit të

lartë dhe Qendrat e Aftësisit Profesional) dhe 40 për qind (për shkollat e mesme profesionale). Format më të përhapura të bashkëpunimit janë praktika e nxënësve (apo trajnimi në vendin e punës), ndjekur nga vizitat e studentëve/pjesëmarrësve të trajnimit dhe kontributi në zhvillimin e kurrikulës.

Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit janë të punësuar në të gjitha ndërmarrjet e anketuara dhe ata përbëjnë një pjesë të rëndësishme të fuqisë punëtore, edhe pse detyrat e tyre dhe të atyre të mobilierëve dhe punëtorë të ngjashëm duket të mos jenë të përkufizuara strikt në ndërmarrjet e Kosovës.

Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit në Kosovë kryejnë këto detyra, të renditura sipas përhapjes së tyre siç raportohet nga ndërmarrjet e anketuara:

- ✓ Operimi dhe monitorimi i makinave të zdrukthëtarisë për prodhimin e pjesëve të drunjtë të mobileve dhe produkteve tjera të drunjtë; në mesin e katër nga pesë ndërmarrje të anketuara përfshihen makinat CNC, megjithatë kjo përqindje pritet të jetë shumë më e ulët në ndërmarrje të tjera të cilat janë më të vogla, mesatarisht.
- ✓ Përzgjedhja e thikave, teheve, sharrave, kokave prerëse, etj. sipas pjesëve për përpunim, funksioneve të makinave dhe specifikimet e produkteve;
- ✓ Instalimi dhe përshtatja e teheve, kokave prerëse, etj;
- ✓ Leximi dhe interpretimi i specifikimeve apo ndjekja e udhëzimeve verbale;
- ✓ Instalimi dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinave të zdrukthëtarisë për operim nga të tjerët.

Sipas punëdhënësve, rëndësia e të gjitha detyrave të mësipërme pritet të rritet në të ardhmen, ndonëse kjo ka më pak të ngjarë të jetë për detyrën e fundit, e cila është gjithashtu më së paku e zakonshme.

Megjithëse ndërmarrjet e anketuara nuk raportojnë dallime (të mëdha) ndërmjet detyrave aktuale dhe të dëshiruara për këtë profesion, analiza të mëtejshme lidhur me kërkesat e aftësive, analizat e kërkesave të aftësive në vende të tjera, dhe njohuri nga intervista më e hollësishme me dy përfaqësues të ndërmarrjeve tregojnë se shkalla e detyrave të punonjësve të këtij profesioni në Kosovë është e kufizuar me aftësi të caktuara. Domethënë, rregullimi dhe programimi i makinave të zdrukthëtarisë, që është edhe pjesë e detyrave sipas klasifikimit ISCO, si dhe detyra të tjera siç është mirëmbajtja dhe kalibrimi i makinerisë, nuk bëhen nga punëtorët në Kosovë.

Për kryerjen e detyrave të punëtorëve për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit, kërkohet njohuri e aftësive specifike dhe të përgjithshme të profesionit, veçanërisht:

- ✓ Aftësitë e leximit dhe gjuhët e huaja, me qëllim të rregullimit të makinerive dhe kryerjen e mirëmbajtjes bazike;
- ✓ Aftësitë në matematikën elementare dhe gjeometri për qëllime të llogaritjes së prodhimit të materialeve;
- ✓ Aftësia për t'i kuptuar dhe interpretuar vizatimet e dizajnit dhe specifikimet e modelit;
- ✓ Njohja e lëndëve të para dhe teknikave dhe mjeteve bazë të zdrukthëtarisë;
- ✓ Njohuritë për proceset dhe komponentët e makinerive, veçanërisht makineritë CNC;
- ✓ Njohja e softuerëve CAD (Computer Aided Design) dhe CAM (Computer Aided Manufacturing) dhe nganjëherë njohja e programimit për punonjësit më të avancuar.

Aftësi tjera të përgjithshme përfshijnë zgjidhjen e problemeve, të menduarit kritik, punën ekipore, pavarësinë, mësimdhënien/ udhëzimin e të tjerëve, përshtatjen e pajisjeve të reja apo materialeve

dhe zhdërvjelltësinë manuale. Këto, si dhe përdorimi i kompjuterëve dhe aftësitë në matematikë veçanërisht konsiderohen të jenë gjithnjë e më të rëndësishme në të ardhmen. Megjithatë, një pjesë e madhe e ndërmarrjeve (midis 43 dhe 73%) e konsiderojnë të diplomuarit (që vijnë nga arsimit terciar dhe i mesëm) ose si 'mjaf' apo 'krejtësisht' të papërgatitur për sa i përket përdorimit të kompjuterëve, përdorimit dhe të kuptuarit të informacioneve numerike, komunikimit në një gjuhë të huaj, zgjidhjes së problemeve komplekse dhe aftësive të leximit.

Rekomandimet në vijim jepen për rritjen e aftësive dhe mundësive të punësimit të fuqisë punëtore, dhe nxitjen e konkurrencës së ndërmarrjeve:

- ✓ Duke pasur parasysh mbizotërimin, peshën dhe rëndësinë në rritje të profesionit për zhvillimin e këtij sektori, është e rëndësishme që standardi profesional të zhvillohet për punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit. Standardi profesional dhe programet e arsimit dhe aftësisit që zhvillohen në të ardhmen duhet të bazohen jo vetëm në detyrat që kryhen dhe aftësitë e kërkuara aktualisht në Kosovë, por edhe në standardet e vendeve të tjera. Programet e tilla të arsimit dhe aftësisit jo vetëm do të rritnin produktivitetin e punonjësve në detyrat që kryhen aktualisht, por kjo do të zvogëlojë nevojën për shërbime të shtrenjta nga jashtë për mirëmbajtje.
- ✓ Rëndësia e madhe dhe në rritje e aftësive të përgjithshme siç është leximi, matematika, zgjidhja e problemeve, të menduarit kritik, etj., në njërin anë, dhe vlerësimi i ulët i përgatitjeve nga ndërmarrjet, nga ana tjetër, vënë në dukje nevojën për të rritur cilësinë e arsimit themelor dhe të sigurohet se programet e shkollimit profesional zhvillojnë aftësitë e përgjithshme së bashku me aftësitë profesionale.
- ✓ Programet e arsimit dhe aftësisit duhet të zhvillojë një kombinim të njohurive të aftësive më 'tradicionale' dhe njohurive të tilla si teknikat bazike të zdrukthëtarisë dhe njohjen e komponentëve dhe proceseve të makinerisë, dhe aftësitë që paraqiten rishtas në veçanti lidhur me përdorimin e makinave CNC dhe softuerët CAD dhe CAM.
- ✓ Duke pasur parasysh ndryshimet e shpejta teknologjike në këtë sektor, shoqëruar me çmimin e lartë të makinave CNC për pajisjen e shkollave dhe laboratorëve për trajnim, është e pashmangshme që të bëhet racionalizimi i burimeve, p.sh. Duke fuqizuar bashkëpunimin në mes të ofruesve të arsimit dhe trajnimit dhe ndërmarrjeve (nëpërmjet formave inovative të bashkëpunimit me iniciativat e duhura për të siguruar fizibilitetin dhe qëndrueshmërinë); dhe/apo duke shkëmbyer burimet ndërmjet ofruesve të arsimit dhe trajnimit (p.sh. Ndërmjet shkollave profesionale dhe Qendrave për Aftësim Profesional).
- ✓ Arsyet për mos-dallimet ndërmjet punëdhënësve sa u përket të diplomuarve nga programet e arsimit dhe aftësisit ekzistues në sektorin specifik duhet të analizohen, veçanërisht duke u fokusuar në cilësinë dhe lidhjen e kurrikulës me tregun. Rënia në regjistrime në programet e arsimit të mesëm lidhur me përpunimin e drurit duhet të analizohet në veçanti, siç edhe duhet të bëhet përshtatja e shpërndarjes gjeografike e shkollave që ofrojnë këto programe me shpërndarjen e ndërmarrjeve që operojnë në këtë sektor.
- ✓ Mundësia e ofruar nga rritja e rëndësisë së makinave CNC duhet të përdoret për të nxitur punësimin e të rinjve, dhe veçanërisht femrat e reja në këtë sektor.

Burimet:

- ALLED, 2016a. Metodologjia për zhvillimin e profilit në sektor, Kosovë 2016. Prishtinë: ALLED.
- ALLED, 2016b. Bujqësia. Prishtinë: ALLED.
- EYE, 2016. Vlerësimi i aftësive për sektorin e përpunimit të drurit në Kosovë. Prishtinë: EYE.
- ASK, 2017. Vlera e shtuar bruto vjetore, të dhëna sipas sektorit. Gjetet online në: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata_07%20National%20and%20government%20accounts_National%20accounts_Annual%20national%20accounts/gdp09.px/tableViewLayout1/?rxid=ad787284-363a-44a5-bb3d-0f067afa36b7 [qasur më 6 shtator 2017]
- MCVET, 2008. Studim i sektorit të drurit: Raport hulumtimi për nevojën e aftësive. Vilnius: MCVET.
- MASHT, 2016. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (2017-2021). Prishtinë: MASHT.
- MTI, 2014. Koncepti i politikave industriale të Kosovës. Prishtinë: MTI.
- MTI dhe UNDP, 2014. Profili i sektorit të industrisë së përpunimit të drurit. Prishtinë: MTI dhe UNDP.
- MTI dhe UNDP, 2015. Tregjet potenciale të eksportit për përpunim të ushqimit, bujqësi, përpunim të drurit, materiale ndërtimore, turizëm dhe artizanate. Prishtinë: MTI dhe UNDP.
- ZKM, 2016. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2020). Prishtinë: Zyra e Kryeministrit.
- UNDP, 2016. Vlerësimi i nevojave të aftësive: Identifikimi i nevojave të punëdhënësve në gjashtë sektorë ekonomik në Kosovë. Prishtinë: UNDP.
- USAID, 2015a. Raport i vlerësimit dhe përzgjedhjes së sektorëve në Kosovë: Vlerësimi i rritjes së mundësive, sfidave dhe ndikimit potencial. USAID: Prishtinë.
- USAID, 2015b. Vlerësim i sektorit të drurit në Kosovë: 2015 Përditësim i mundësive dhe sfidave. USAID: Prishtinë.
- WMC, 2008. Standardi kombëtar profesional për sektorin e përpunimit të avancuar të produkteve të drurit në Kanada: Operatorët e CNC. Ottawa: Këshilli për prodhimet e drurit.

Shtojcë: Çelësi i profesioneve ISCO-08

1	Menaxherë
13	Menaxherë të prodhimit dhe për shërbime të specializuara
	132 Menaxherë të prodhimit, minierave, ndërtimtarisë dhe shpërndarjes
	1321 Menaxherë të prodhimit
2	Profesionistë
21	Profesionistë të shkencës dhe inxhinierisë
214	Profesionistë të inxhinierisë (me përjashtim të Elektro-teknologjisë)
	2141 Inxhinierët industrial dhe të prodhimit
3	Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional
31	Bashkëpunëtorët profesional të shkencës dhe inxhinierisë
311	Teknikët e shkencave fizike dhe të inxhinierisë
	3115 Teknikët e inxhinierisë mekanike
312	Mbikëqyrësit e minierave, prodhimit dhe ndërtimit
	3122 Mbikëqyrësit e prodhimit
7	Punonjësi e zejes dhe profesioneve të ngjashme
71	Punonjësit e ndërtimit dhe profesioneve të ngjashme (me përjashtim të elektricistëve)
	711 Punëtorët e kornizave të ndërtimit dhe profesioneve të ngjashme
	7111 Ndërtuesit e shtëpive
	7112 Muratorët dhe punëtorët e ngjashëm
	7113 Gurgdhendës, punëtorët për prerjen e gurit, ndarje dhe gdhendje
	7114 Punëtorët për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe të ngjashëm
	7115 Zdrukthëtarë dhe mobilierë
73	Punonjësit e artizanatit dhe printimit
731	Punonjësit e artizanatit
	7317 Punëtorët e zejes me dru, shportari dhe materiale të ngjashme
75	Punëtorët në përpunimin e ushqimit, punimin e drurit, veshjeve dhe zejeve tjera dhe profesioneve të ngjashme
752	Trajtuesit e drurit, mobilierët dhe punonjësit e profesioneve të ndërlidhura
	7521 Trajtuesit e drurit
	7522 Mobilierët dhe punëtorët e ngjashëm
	7523 Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e drurit
	817 Punëtorët e fabrikës për përpunimin e drurit dhe prodhimin e letrës
	8171 Punëtorët e fabrikës për pulpë dhe prodhimin e letrës
	8172 Punëtorët e fabrikës për përpunimin e drurit
8	Operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina
82	Montuesit
821	Montuesit
	8219 Montuesit e paklasifikuar diku tjetër



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

